

VENDIM
Nr.391, datë 21.2.2008

PËR SHPALLJEN “ZONË EKONOMIKE”, NË SPITALLË, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Park industrial”, të territorit, me sipërfaqe 850 ha, pjesë e zonës kadastrale nr.8517, në Spitallë, Durrës, në përbërje të së cilës janë parcelat me numër pasurie, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtrirja dhe kufizimet e kësaj zone specifikohen në hartën treguese, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Në këtë zonë do të zhvillohen veprimtari:

- prodhuese, industriale dhe agropërpunimi;
- tregtare;
- shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 vjet.

5. Zona jepet me koncesion.

6. Procedura e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës të bëhet në mbështetje të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, si dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit për ndihmën shtetërore.

7. Veprimtarive tregtare, që do të zhvillohen brenda zonës e që plotësojnë kriteret e përcaktuara në dispozitat e Kodit Doganor, t’u jepet statusi i magazinës doganore.

Gjithashtu, të shihet me përparësi dhënia e këtij statusi edhe veprimtarive përpunuese në mjediset e këtyre magazinave doganore.

8. Për veprimtaritë që do të zhvillohen në zonën ekonomike të bëhet, brenda 1 muaji, rimbursimi i TVSH-së, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Për pjesët e truallit të kësaj zone, që janë pronë private, të bëhet shpronësimi dhe/ose kompensimi, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

10. Ngarkohet Ministria e Financave të bëjë planifikimin e fondit për kompensimin e pronarëve.

11. Vendimi nr.306, datë 30.6.1994 i Këshillit të Ministrave “Për masat, që do të merren për zonat e përbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve, në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”, shfuqizohet.

12. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



PARCELAT ME NUMRAT E POSHTËSHËNUAR TË PASURIVE

15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	31
32/1	32/2	32/3	32/4	32/5	32/6	32/7	33/1	33/2	33/3	33/4
33/5	33/6	33/7	33/8	34/1	34/2	34/3	34/4	34/5	34/6	34/7
34/8	34/9	35	36	37	38	39	40	41	42	43/17
44	45	46	47	48	49	50	51/1	51/2	51/3	51/4
51/5	51/6	51/7	51/8	51/9	51/10	52/1	52/2	52/3	52/4	52/5
52/6	52/7	52/8	52/9	52/10	52/11	52/12	52/13	52/14	52/15	52/16
52/17	53/1	53/2	53/3	53/4	53/5	53/6	53/7	53/8	53/9	53/10
53/11	53/12	53/13	53/14	53/15	54/1	54/2	54/3	54/4	54/5	54/6
54/7	54/8	54/9	54/10	54/11	54/12	54/13	54/14	54/15	54/16	54/17
54/18	54/19	54/20	54/21	54/22	54/23	54/24	54/25	59/1	59/2	59/3
59/4	59/5	59/6	59/7	59/8	59/9	59/10	59/11	59/12	59/13	59/14
59/15	59/16	59/17	59/18	59/19	59/20	59/21	59/22	59/23	60/1	60/2
60/3	60/4	60/5	60/6	60/7	60/8	60/9	60/10	60/11	60/12	60/13
60/14	60/15	60/16	60/17	60/18	61/1	61/2	61/3	61/4	61/5	61/6
61/7	61/8	61/9	61/10	61/11	61/12	61/13	61/14	61/15	61/16	61/17
61/18	61/19	61/20	61/21	61/22	61/23	61/24	61/25	61/26	61/27	61/28
61/29	61/30	61/31	61/32	61/33	61/34	61/35	61/36	62/1	62/2	62/3
62/4	62/5	62/6	62/7	62/8	62/9	62/10	62/11	62/12	62/13	62/14
62/15	62/16	63	64	65	66	67/1	67/2	67/3	67/4	68
69/1	69/2	69/3	69/4	69/5	69/6	69/7	69/8	69/9	69/10	69/11
69/12	69/13	69/14	69/15	69/16	69/17	69/18	69/19	69/20	69/21	69/22
69/23	70/1	70/2	70/3	70/4	70/5	70/6	70/7	70/8	70/9	70/10
70/11	70/12	70/13	70/14	70/15	70/16	70/17	70/18	70/19	70/20	70/21
70/22	70/23	70/24	70/25	70/26	70/27	70/28	70/29	70/30	70/31	70/32
70/33	70/34	72/1	72/2	72/3	72/4	72/5	72/6	72/7	72/8	74/1
74/2	74/3	74/4	74/5	74/6	74/7	74/8	74/9	74/10	76	78
79	80	81	82/1	82/2	82/3	82/4	82/5	82/6	82/7	82/8
82/9	82/10	82/11	82/12	82/13	82/14	83/1	83/2	83/3	83/4	83/5
83/6	83/7	83/8	83/9	83/10	83/11	83/12	83/13	83/14	83/15	83/16
84/1	84/2	84/3	84/4	84/5	84/6	84/7	84/8	84/9	85/1	85/2
85/3	85/4	85/5	85/6	85/7	85/8	85/9	98/1	98/2	98/3	98/4
98/5	98/6	99/1	99/2	99/3	99/4	100/1	100/2	100/3	100/4	101/1
101/2	101/3	102/1	102/2	102/3	102/4	102/5	102/6	103/1	103/2	103/3
103/4	103/5	103/6	103/7	103/8	104/1	104/2	104/3	104/4	104/5	104/6
104/7	104/8	104/9	104/10	104/11	104/12	105/1	105/2	105/3	105/4	105/5
105/6	106/1	106/2	106/3	106/4	106/5	107/1	107/2	107/3	107/4	107/5
107/6	107/7	107/8	107/9	107/10	107/11	107/12	107/13	107/14	107/15	107/16
107/17	107/18	107/19	107/20	108/1	108/2	108/3	108/4	108/5	147	